



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:150557

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05312116

Pml.nr.56/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarës A. B., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par. 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1004/2021 të datës 16.03.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.743/2023 të datës 28.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7 shkurt 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarës A. B. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.1004/2021 të datës 16.03.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.743/2023 të datës 28.09.2023.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.1004/2021 e datës 16.03.2023, të dënuarën A. B. e ka shpallur fajtores për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 08.07.2021 deri më datë 05.09.2021. E dënuara është obliguar në pagesën e shumës prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 60 € në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe shumën prej 50 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.743/2023 e datës 28.09.2023, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarës A. B., avokati Shemsedin Pira nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe aktgjykimet e kundërshtuara t'i anulon dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.30/2024 e datës 31.01.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarës pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë pavarësisht se e dënuara ka bërë pranimin e fajësisë në dispozitiv të aktgjyimit nuk është përshkruar shpejtësia e zhvilluar në momentin e aksidentit, si dhe shpejtësia e lejuar në vendin e aksidentit, për më tepër, duke u bazuar në ekspertizën e eksperti të komunikacionit del se nuk është përcaktuar shpejtësia

e lëvizjes ngase në momentin e ndodhjes së aksidentit shpejtësia e lëvizjes së automjetit ka filluar të zvogëlohet dhe është përshtatur me shpejtësinë e lëvizjes me kushtet e trafikut në këtë pjesë të rrugës. Pretendohet se në këtë pjesë të rrugës nuk ka pasur shenja të komunikacionit dhe e dënuara ka zhvilluar shpejtësi të duhur në përputhshmëri me kushtet e rrugës pasi që nuk kanë ekzistuar as shenjat horizontale dhe as vertikale në rrugë.

Pretendohet se gjykatat në rastin konkret kundër të dënuarës kanë shqiptuar dënim të lartë pasi që edhe me një dënim më të butë do të arrihej qëllimi i dënimit dhe me këtë rast nuk kanë pasur parasysh rrethanat lehtësuese se e dënuara ka bërë pranimin e fajësisë, se të ndjerën M. D., por edhe të dëmtuarat F. B. dhe A. I. i ka pasur shoqe të ngushta, kurse familja e të ndjerës dhe të dëmtuarat nuk kanë kërkuar kompensim dëmi dhe as nuk i janë bashkëngjitur ndjekjes penale, kurse e dënuara ka shprehur keqardhje të thellë dhe për rastin e ndodhur duke premtuar se nuk do të bie ndesh me ligjin.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa e mbrojtësit të të dënuarës është e pabazuar.

Fillimisht duhet theksuar faktin se e dënuara në shqyrtimin fillestar dhe atë në prani të mbrojtësit të saj kishte bërë pranimin e fajësisë, për më tepër, bazuar në procesverbalin e shqyrtimit fillestar të datës 16.03.2023 del se e dënuara e as mbrojtësi i saj nuk kanë kontestuar asnjë nga kriteret e përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPP-së dhe se si rezultat i këtij konstatimi gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se janë përmbushur kriteret e përcaktuara duke aprovuar pranimin e fajësisë.

Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë pretendime të pabazuara, meqë gjykatat e dy instancave më të ulëta gjyqësore me të drejtë kanë konstatuar se në veprimet e të dënuarës janë formësuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së. Përtej kësaj, dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë del se është në harmoni të plotë me përshkrimin e tij,

për më tepër, në përmbajtjen e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është referuar në normën blankete e cila është shkelur nga ana e të dënuarës dhe atë nenit 53 par.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor - Ligji Nr. 05/L-88, ku është përcaktuar se: *“Shoferi duhet t’ua përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe fushëpamjes së rrugës, gjendjes dhe llojit të rrugës, kushteve teknike, kushteve atmosferike, ngarkesës së mjetit, dendësisë së trafikut, gjendjes psikofizike të tij dhe aftësive personale të tij, ashtu që të jetë në gjendje ta ndalë mjetin para çdo pengese që mund të paraqitet në kushte të dhëna - brenda kufijve të fushëpamjes, përkatësisht, të mund të veprojë me kohë”*.

Ashtu që duke marrë parasysh dispozitën e lartë cekur rrjedh se e dënuara nuk ka pasur kujdesin e duhur me rastin e drejtimit të automjetit, përkatësisht nuk e përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve të rrugës- kthesës së rrezikshme, në atë mënyrë që me shpejtësi të madhe hynë në kthesën e rrezikshme të anës së djathtë dhe në pamundësi për ta përballuar kthesën humb kontrollin në automjet dhe del nga rruga duke u përmbysur në lumin Morava. Me këtë rast edhe sipas dispozitës ligjore të lartë cekur (nenit 53 par.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor - Ligji Nr. 05/L-88) del se është irelevante shpejtësia e zhvilluar, por relevante paraqet fakti se e dënuara nuk i ka përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë, përkatësisht kthesës duke ardhur deri te pasojat e shkaktuara e cila në mënyrë të plotë dhe të detajuar është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke shqyrtuar pretendimet përkitazi me shkeljen e ligjit penal vëren faktin se duke u bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, vendimi për dënim nuk mund të kundërshtohet, kurse shkelja e ligjit penal vlerësohet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkaluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkaluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Për më tepër, me rastin e çmuarjes së rrethanave për përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata e shkallës së parë ka pasur parasysh të gjitha rrethanat e rëndësishme dhe mes tjerash edhe relacionet e të dënuarës dhe tani të ndjerës dhe të dëmtuarave, megjithatë ka konstatuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata supreme e Kosovës vëren se përkundër faktit se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, bazuar në përmbajtjen e saj janë paraqitur pretendime përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Mirëpo, bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj pjesa e kërkesës e paraqitur për këtë bazë është refuzuar si e pabazuar.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.56/2024, më 7 shkurt 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala